



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0484

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE DWH-KOSOVA SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS” me numër të prokurimit 635-26-5317-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, më 28/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar ankesa e DWH-KOSOVA SH.P.K. me nr. 2026/0484 , e datës 10/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS”, me numër të prokurimit 635-26-5317-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E PEJES.
2. **Lejohet** Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E PEJES të vazhdojë aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS”, me numër të prokurimit 635-26-5317-1-2-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.07.2025. KOMUNA E PEJES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS” me nr. të prokurimit: "635-26-5317-1-2-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 24,680.00 €.

Me 06.07.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 07.07.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.07.2026, OEDWH-KOSOVA SH.P.K.” ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0484, kundër njoftimit për kontratë.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues DWH-KOSOVA SH.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Ne ankojmë vendimin e AK, KK Pejë, pa numër, datë 07.07.2026 dhe kërkojmë rrëzimin e tij, si dhe kthimin e tenderit në shtratin ligjor, konform Nenit 04/L-042, Neni 1, 7, 28 dhe 71.

Produktet e kërkuara nga AK janë bazuar 100% në produkte të caktuara, ku është parazgjedhur prodhuesi, tipet e mjeteve të kërkuara, dhe si rrjedhojë edhe OE respektiv, si edhe jepen në tabelën e mëposhtme.

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 7, 28, 71 dhe si rrjedhojë edhe me Nenin 1 të LPP të RK.

Për më tej, AK, në vend që të reflektonte dhe të merrte të gjitha masat, që të sillte tenderin në shtratin ligjor, e ka rrëzuar kërkesën tonë për rishikim në mënyrë arrogante dhe arbitrare, pa argumentuar vendimin e vet.

AK nuk i përgjigjet me fakte kërkesës për Rishikim të OE ankues, por e rrëzon atë, duke iu referuar vetvetes me fjali parazitare, si p.sh. "specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat e AK" apo "në dosje nuk janë përmendur emrat e prodhuesve".

"Naiviteti" i AK është mbresëlënës, sepse duke marrë germë për germë specifikimet e produkteve të caktuara nga pozicioni 1.1 deri 1.12 dhe duke i hequr emrin e prodhuesit ose tipit të produktit, nuk është se ai produkt bëhet anonim. Ai mbetet po ai produkt.

AK ka kërkuar që OE të abonohet me financat e veta GNSS e AK në KOPOS (shërbim i AKK) për një vit. Edhe kjo kërkesë e përdhosur për AK është normale. Pra, nëse AK do të fuste në tender edhe një automjet lëvizës (Kerr), do të mund të kërkonte me këtë logjikë edhe karburantin për një vit.

Çfarë ndodh nëse GNSS nuk do të ketë akses në KOPOS në një moment të caktuar? Lindin disa pyetje:

1. Kush e ka detyrimin për të gjetur arsyen dhe zgjidhjen? AK apo OE?
2. Kujt i mbetet përgjegjësia për zgjidhjen?
3. Cilat janë limitet kohore?
4. Sa janë këto shpenzime për një vit (veç abonimit)?
5. A është ligjërisht e mundur që një OE të regjistrojë produkt të tretë, për më tepër ent publik?
6. Cili është motivi që detyrime të tilla fikse AK ia delegon një OE?

Lista e pyetjeve të tilla është pa fund, por ne po ndalemi me kaq.

Këtyre problemeve AK as që merr përsipër t'i sqarojë si teknikisht, edhe ligjërisht.

Ne kërkojmë rrëzimin e vendimit, si dhe obligimin e AK të ndryshojë kërkesat konform LPP të RK.

Përshëndetje Institucionale

DWHKS Team

7. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

8. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/letres së tenderuesit të pasuksesshëm/letres për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues, duke përfshirë e-mailat, si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Me datën 06.07.2026, operatori ekonomik DWH-KOSOVA SH.P.K. ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (KOMUNA E PEJËS) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si më poshtë:

PËRGJIGJET NGA NJËSIA KËRKUESE NË PRETENDIMIN E OE DWH-KOSOVA SH.P.K.

Përgjigja për Zyrën e Prokurimit në Komunën e Pejës lidhur me kërkesën për shqyrtim

Lidhur me kërkesën tuaj për sqarim dhe pretendimet e paraqitura në lidhje me dokumentacionin e tenderit, ju njoftojmë se pas shqyrtimit të tyre konstatojmë se ato nuk qëndrojnë.

Specifikimet teknike të përfshira në dosjen e tenderit janë hartuar në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktues dhe nuk përmbajnë emrin e asnjë prodhuesi, marke, firme apo operatori ekonomik të caktuar. Për rrjedhojë, nuk është favorizuar asnjë prodhues apo operator ekonomik, ndërsa të gjithë operatorët ekonomikë që ofrojnë produkte që i plotësojnë specifikimet teknike kanë mundësi të barabartë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Sa i përket pretendimit lidhur me shërbimin KOPOS, sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik fitues të përfshijë në ofertë pagesën e tarifës së shërbimit vetëm për vitin e parë të përdorimit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, të gjitha tarifat dhe pagesat për vazhdimin e shërbimit KOPOS do të mbulohen nga Komuna. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën dhe nuk krijon avantazh për ndonjë operator ekonomik të caktuar, por është pjesë e kërkesave funksionale të kontratës.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk ekzistojnë arsye ligjore apo teknike për ndryshimin e strukturës së tenderit ose ndarjen e tij në lote, pasi dokumentacioni është përgatitur në përputhje me nevojat operative dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Prandaj, në këtë fazë nuk konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i dokumentacionit të tenderit. Ju falënderojmë për interesimin dhe kontributin tuaj në këtë procedurë të prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 13.07.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0484, ndërsa me datë 17.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0484, me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar ndërsa AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEDWH-KOSOVA SH.P.K."eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0484 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimet e ngritura ankimore, të cilat i takojnë karakterit teknik, janë shqyrtuar nga eksperti teknik.

Pretendimi ankimor 1

Sipas operatorit ekonomik ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor si në vijim: Ne ankojmë vendimin e AK, KK Pejë, pa numër, datë 07.07.2026 dhe kërkojmë rrëzimin e tij, si kthimin e tenderit në shtratin ligjor, konform Nenit 04/L-042, Neni 1, 7, 28 dhe 71. Produktet e kërkuara nga AK janë bazuar 100% në produkte të caktuara, ku është parazgjedhur prodhuesi, tipet e mjeteve të kërkuara, dhe si rrjedhojë edhe OE respektiv, si edhe jepen në tabelën e mëposhtme.

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 7, 28, 71 dhe si rrjedhojë edhe me nenin 1 të LPP të RK. Për më tej AK, në vend që të reflektonte dhe të merrte të gjitha masat, që të sillte tenderin në shtratin ligjor, e ka rrëzuar kërkesën tonë për rishikim në mënyrë arrogante dhe arbitrare, pa argumentuar vendimin e vet. AK nuk i përgjigjet me fakte kërkesës për Rishikim të OE ankimues, por e rrëzon atë, duke iu referuar vetvetes me fjali parazitare si p.sh. "specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat e AK" apo "në dosje nuk janë përmendur emrat e prodhuesve". "Naiviteti" i AK është mbresëlënëse, sepse duke marrë germë për germë specifikimet e produkteve të caktuara nga pozicioni 1.1 deri 1.12 dhe duke i hequr emrin e prodhuesit ose tipit të produktit, nuk është se ai produkt bëhet anonim. Ai mbetet po ai produkt.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Sa i përket pretendimit të parë, eksperti teknik thekson se: Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se specifikimet teknike janë hartuar për një prodhues apo operator ekonomik të caktuar, pas shqyrtimit të specifikimeve të kërkuara konstatohet se ky pretendim nuk është i mbështetur nga aspekti teknik. Specifikimet teknike të përfshira në dosjen e tenderit paraqesin kërkesat dhe nevojat e Autoritetit Kontraktues, të cilat janë përcaktuar nga njësi kërkuuese në bazë të pajisjeve dhe funksionaliteteve që i nevojiten për kryerjen e detyrave të saj. Vlerësimi nëse këto karakteristika janë të nevojshme ose jo nuk është kompetencë e imja si ekspert teknik, pasi përcaktimi i nevojave është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues.

Sa i përket pretendimit se është paracaktuar një prodhues i caktuar, nga shqyrtimi i specifikimeve nuk rezulton se në ndonjërin prej artikujve është përmendur emri i ndonjë prodhuesi apo marke të caktuar. Po ashtu, nuk është dëshmuar se specifikimet e kërkuara mund të plotësohen vetëm nga një prodhues i vetëm, pasi në treg ekzistojnë edhe prodhues të tjerë që ofrojnë pajisje me karakteristika të njëjta ose të përafërta. Për këtë arsye, vetëm fakti që një operator ekonomik nuk e ka në ofertën e tij një produkt me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të konsiderohet si provë se specifikimet janë diskriminuese ose se janë hartuar për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar. Vetëm sa i përket artikullit 1.12, konstatohet se specifikimet

teknike janë përshkruar në mënyrë më të detajuar dhe në fund është përdorur referenca "ekuivalent me modelin DJI Mavic 3 Enterprise me RTK të integruar"; megjithatë, është përdorur shprehja "ekuivalent", e cila nënkupton se nuk kërkohet domosdoshmërisht ai model, por pranohen edhe produkte të tjera që përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Prandaj, nga aspekti teknik, nuk është vërtetuar pretendimi se specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyrë që të kufizojnë konkurrencën ose të përcaktojnë një prodhues të vetëm, ndërsa nevojat dhe kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit mbeten në përgjegjësi të Autoritetit Kontraktues dhe njësisë kërkuese që ka iniciuar këtë procedurë të prokurimit.

Andaj, eksperti teknik në rastin konkret konstaton se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

Sipas operatorit ekonomik ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor si në vijim: AK ka kërkuar që OE të abonohet me financat e veta GNSS e AK në KOPOS (shërbim i AKK) për një vit. Edhe kjo kërkesë e përçudnuar për AK është normale. Pra, nëse AK do të fuste në tender edhe një automjet lëvizës (Kerr), do të mund të kërkonte me këtë logjikë edhe karburantin për një vit.

Çfarë ndodh nëse GNSS nuk do të ketë akses në Kopus në një moment të caktuar? Lindin disa pyetje:

1. Kush e ka detyrimin për të gjetur arsyen dhe zgjidhjen? AK apo OE?
2. Kujt i mbetet përgjegjësia për zgjidhjen?
3. Cilat janë limitet kohore?
4. Sa janë këto shpenzime për një vit (veç abonimit)?
5. A është ligjërish e mundur që një OE të regjistrojë produkt të tretë, për më tepër ent publik?
6. Cili është motivi që detyrime të tilla fikse AK ia delegon një OE?

Lista e pyetjeve të tilla është pa fund, por ne po ndalemi me kaq. Këtyre problemeve AK as që merr përsipër ti sqarojë si teknikisht, edhe ligjërish. Ne kërkojmë rrëzimin e vendimit, si dhe obligimin e AK të ndryshojë kërkesat konform LPP të RK.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Sa i përket pretendimit të dytë, eksperti teknik thekson se: Lidhur me këtë pretendim, konstatoj se Autoriteti Kontraktues në paramasë ka paraparë në mënyrë të qartë pozicionin 1.4 - "Abonim njëvjeçar për user të GPS nga Agjencia Kadastrale e Kosovës". Ky abonim është pjesë e kërkesës së tenderit dhe operatori ekonomik që shpallet fitues ka për obligim ta sigurojë dhe ta paguajë vetëm për vitin e parë, si pjesë e ofertës së tij. Tarifat për këtë shërbim janë të përcaktuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe vlejnë njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë. Për këtë arsye, pretendimi nuk qëndron, pasi bëhet fjalë vetëm për një abonim njëvjeçar të paraparë në dosjen e tenderit.

Andaj, eksperti teknik në rastin konkret konstaton se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit KOMUNA E PEJES.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi..



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: